

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 10 dhe nenit 15 paragrafi (3) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10), dhe duke vepruar sipas Njoftimit për Ndarjen e Planifikuar të Ndihmës të dorëzuar nga Ministria e Financave nr. 15-681/1 të datës 22.01.2024, në seancën e mbajtur më 24.01.2024, miratoi

AKTVENDIM

Propozim-Ligji për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për detyrimet sipas Marrëveshjes së Huasë për financimin e Projektit për Gazifikimin Rajonal, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike, transmetimin e gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, e cila si ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, jepet nga Ministria e Financave dhe dhënia e saj është e lejuar në bazë të nenit 8 paragrafi (2) pika b) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, sepse bëhet fjalë për ndihmë që synon promovimin e realizimit të projekteve me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë.

Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

ARSYETIM

Sipas nenit 10 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore (në tekstin e mëtejshëm "Ligji"), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm "Komisioni") është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme të ndihmës shtetërore.

Çdo ofrues i ndihmës shtetërore, i përcaktuar në nenin 6 paragrafi (1) të Ligjit, është i detyruar, sipas nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit, t'i dorëzojë Komisionit njoftim për çdo plan për dhënien e ndihmës së re ose ndryshimin e ndihmës shtetërore ekzistuese, pavarësisht nëse ajo jepet si ndihmë individuale apo si skemë ndihme.

Në lidhje me Propozim-Ligjin për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për detyrimet sipas Marrëveshjes së Huasë për financimin e Projektit për Gazifikimin Rajonal, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike, transmetimin e gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore (në tekstin e mëtejshëm: Propozim-Ligji), Ministria e Financave me shkresën nr. 15-681/1 të datës 22.01.2024 (Nr. ynë 10-28 të datës 22.01.2024) dorëzoi Njoftim për garancinë që i jepet Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike, transmetimin e gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore (në tekstin e mëtejshëm: NOMAGAS) nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Ministrisë së Financave në përputhje me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e dorëzimit të njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën e mbikëqyrjes së ndihmës shtetërore ekzistuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/11).

Komisioni vlerësoi se Njoftimi i dorëzuar nga Ministria e Financave është i rregullt dhe përmban të gjitha të dhënat e parashikuara në nenin 14 paragrafi (1) të Ligjit, gjegjësisht se një njoftim i tillë në formë dhe përmbajtje është në përputhje me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e dorëzimit të njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën e mbikëqyrjes së ndihmës shtetërore ekzistuese (në tekstin e mëtejme "Rregullore").

Për të përcaktuar nëse një masë e ndërmarrë nga ofruesit e ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore, vlerësohet plotësimi në mënyrë kumulative i katër kritereve të mëposhtme:

- Që masa e tillë të përfshijë një shpenzim potencial ose të realizuar të mjeteve shtetërore;
- Të jetë selektive;
- Të përbëjë një avantazh ekonomik për marrësin dhe
- Të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti.

Sipas Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, jep ndihmë shtetërore në formën e një garancie individuale për Shoqërinë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike, transmetimin e gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore.

Komisioni konstatoi se Propozim-Ligji përbën ndihmë shtetërore për shkak të faktit se:

- Përfshin një shpenzim potencial të mjeteve shtetërore sepse në nenin 1 të Propozim-Ligjit është parashikuar që Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes së Huasë për financimin e Projektit për Gazifikimin Rajonal, që do të lidhet ndërmjet Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike, transmetimin e gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në vlerë deri në 98.600.000 euro, nëse Shoqëria Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike, transmetimin e gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore nuk i përmbush dhe shërben detyrimet nga Marrëveshja e Huasë;
- Selektiviteti shihet në faktin e përcaktimit të vetëm një operatori ekonomik - Shoqërisë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike, transmetimin e gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore, e cila merr garancinë;
- Përbën një avantazh për marrësin sepse me ndihmën e tillë të dhënë i mundësohet një avantazh ekonomik në treg krahasuar me konkurrentët e tjerë që nuk do të marrin një lloj të tillë ndihme dhe
- Një ndihmë e tillë ka ose mund të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti sepse konkurrenca dëmtohet ose mund të dëmtohet përmes mundësimit të një avantazhi ekonomik për Shoqërinë Aksionare për kryerjen e veprimtarisë energjetike, transmetimin e gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore.

Në këtë rast, gjatë shqyrtimit të lejueshmërisë së ndihmës shtetërore, dhe në përputhje me nenin 3 paragrafi (3) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zbaton Njoftimin e Komisionit Evropian për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore në formën e garancive (Commission Notice on the application of Articles 87 and 88 of the EC Treaty to State aid in the form of guarantees – EUR-Lex – 52008XC0620(02) - në tekstin e mëtejme Njoftimi).

Vlerësimi i ndihmës shtetërore nga ana e Komisionit bazohet në pikën 3.2 të Njoftimit (garancitë individuale).

Në këtë pikë, përmes plotësimit të kushteve të caktuara, theksohet se si përcaktohet nëse ekziston apo jo ndihmë shtetërore në garancinë e lëshuar. Plotësimi i kushteve të theksuara në pikën 3.2. të Njoftimit nuk nënkupton ndihmë shtetërore për garancinë e dhënë shtetërore, nëse: a) ndërmarrja nuk është në vështirësi financiare; b) vëllimi i garancisë mund të matet saktësisht në momentin kur do të jepet (garancia duhet të jetë e lidhur me një transaksion financiar të caktuar, për një shumë maksimale fikse dhe e kufizuar në kohë); c) garancia nuk mbulon më shumë se 80% të huasë së mbetur ose mjeteve të tjera financiare (ndërsa borxhi ulet, garancia të mos mbulojë më shumë se 80% të huasë së mbetur ose detyrimit financiar), me përjashtim për ndërmarrjet që kryejnë shërbime të interesit ekonomik të përgjithshëm dhe d) garancia e dhënë duhet të kompensohet me një premi të përshtatshëm.

Duke marrë parasysh se në këtë rast nuk është plotësuar kushti i fundit, Komisioni vlerëson se në këtë rast bëhet fjalë për ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore.

Në Njoftim është theksuar se projekti për gazifikimin rajonal është i rëndësishëm strategjik për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Projekti përfshin interkonjeksionin me Greqinë (66 km) dhe dy segmente: Gostivar – Kërçovë (34 km) dhe Sveti Nikole – Veles (28 km). Implementimi i këtij projekti do të kontribuojë në sigurimin e rritjes ekonomike të përsheptuar dhe të qëndrueshme, një standard dhe cilësi më të lartë jetese për qytetarët, zhvillim ekonomik të rajonit dhe bashkëpunim energjetik rajonal. Përveç kësaj, promovohet edhe mbrojtja e mjedisit me shfrytëzimin më të madh të gazit natyror si energjent më i pastër ekologjikisht dhe zvogëlimin e prodhimit të dyoksidit të karbonit nga lëndët djegëse të ngurta që përdoren kryesisht në vend. Sipas strategjive dhe planeve kombëtare për zhvillimin e energjisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gazi natyror përbën një energjent tranzitor drejt energjisë së gjelbër dhe disponueshmëria e tij më e gjerë është një kontribut për zhvillimin e energjisë së gjelbër.

Realizimi i projektit përfshin ndërtimin e një gazsjellësi magjstral për transmetimin e gazit natyror për lidhjen e Republikës së Maqedonisë me Republikën e Greqisë, me çka do të mundësohet siguri i sasive shtesë nga një burim tjetër furnizimi me gaz natyror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, diversifikimi, siguria e furnizimit dhe mundësia për zvogëlimin e çmimit të importit të gazit natyror, sepse do të sigurohet disponueshmëria e gazit natyror nga më shumë burime të ndryshme.

Ky projekt është parashikuar në dokumentet strategjike:

- Programi i Punës i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2020 – 2024;
- Lista Unike me Projekte Prioritare, të miratuara nga Qeveria më 05.01.2021 dhe
- Programi për Reforma Ekonomike 2024 – 2026.

Përveç kësaj, projekti mbështetet nga Komisioni Evropian, kështu që i njëjti është përgatitur me ndihmën teknike të BE-së – CONNECTA, ndërsa në dhjetor 2020, në kuadër të Kornizës Investuese të BE-së për Ballkanin Perëndimor – WBIF, janë siguruar 12.724.000 euro grant WBIF (9.900.000 euro grant investimi, 2.475.000 euro grant për mbështetje teknike, 50.000 euro për komunikime dhe dukshmëri të projektit dhe 299.000 euro provizion për menaxhim për EIB). Marrëveshja e grantit është lidhur më 22.12.2021.

Nga sa u tha më sipër, Komisioni konkludoi se Propozim-Ligji përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit, për shkak të faktit se ndihma e tillë e dhënë nënkupton

një shpenzim të shtetit dhe ajo dëmton ose mund të dëmtojë konkurrencën duke mundësuar një avantazh ekonomik për një ndërmarrje të caktuar, i cili nuk do të ishte i mundur pa ndihmën shtetërore të dhënë ose përmes favorizimit të prodhimit të mallrave të caktuara ose ofrimit të shërbimeve të caktuara. Kjo ndihmë shtetërore e dhënë nga Ministria e Financave është e lejuar në kuptim të nenit 8 paragrafi (2) pika b) i Ligjit, pasi bëhet fjalë për ndihmë që synon promovimin e realizimit të projekteve me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë.

Për shkak të sa më sipër, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Sipas nenit 26 paragrafi (3) i Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, padia nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit, përveç në rastin kur Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës urdhëron kthimin e ndihmës shtetërore të paligjshme ose të keqpërdorur, dhënia e të cilës nuk është e lejuar.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ brenda afatit prej 30 ditësh nga data e marrjes së vendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска